

VENDIM
Nr.586, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT PJESOR, TË VLERAVE FINANCIARE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “NAHLEL” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kushtet dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, në administrim sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara, në bankë, nga shitja e aseteve, dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë, ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, në administrim, dhe të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, Tiranë janë 2 192 799 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “NAHLEL sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 27 594 790 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Numri i kreditorëve, të cilëve do t’u shpërndahen vlerat financiare, është 259 veta.

3. Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 7.94 për qind.

4. Shpërndarja e vlerave financiare kreditorëve do të kryhet në degën e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, sipas marrëveshjes, që do të lidhë Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

5. Për shërbimin e kryerjes së pagesës së kreditorëve nga Dega e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, Grupi Mbikëqyrës do t’i paguajë bankës një komision bankar, në shumën 100 lekë për çdo kreditor, me vlerën 25 900 (njëzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë.

6. Kjo shumë do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, e cila do t’i shtohet Grupit Mbikëqyrës, në planin financiar, të vitit 2007, zëri “shpenzime”.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha